

Përmbledhje e Camden Together- Jepni mendimin tuaj për të ardhmen e Camden-it

Kjo është një përmbledhje e dokumentit të konsultimit *Camden Together*, i cili ju jep mundësinë të ndikoni në të ardhmen e Camden-it

Camden Together i fundit do të jetë një plan për Camden-in që do të vendosë në hartë se si do të duket bashkia jonë në 2012. Përpara se të vendosim për këtë plan, ne duam pikëpamjet e sa më shumë njerëzve të komunitetit që të jetë e mundur, në lidhje me disa nga idetë që kemi.

Kjo përmbledhje parashtron disa nga sfidat kryesore me të cilat përballemi në Camden dhe disa nga mënyrat me të cilat ne mund ta bëjmë Camden-in një vend më të mirë për secilin. Ajo paraqet disa nga gjërat që ne mund të bëjmë midis periudhës së tanishme e deri në 2012 dhe kërkon mendimet tuaja për disa pyetje specifike.

Ne e duam që *Camden Together* të nxisë një debat të ndershëm dhe të hapur rreth çështjeve dhe zgjedhjeve të vështira. Ne duam gjithashtu të reflektojmë se si të përdorim sa më mirë burimet e kufizuara dhe të mendojmë se çfarë mund të bëjnë komunitetet dhe individët për ta bërë jetën më të mirë në Camden si dhe çfarë mund të bëjnë shërbimet publike dhe institucionet.

Lutemi lexoni këtë përmbledhje dhe mendoni për çështjet që ngrihen aty. Ne do të ishim të kënaqur të dëgjonim mendimet tuaja për këto dhe për çështje të tjera që ndikojnë në të ardhmen e Camden-it.

Ne gjithashtu shpresojmë që ju do të doni të shikoni dokumentin e plotë, i cili jep më shumë fakte për Camden-in tani dhe shpjegon më plotësisht disa nga opsionet dhe idetë. Ju mund të lexoni ose të nxirrni një kopje nga interneti të dokumentit të plotë në sitin (website) camdentogether.org.uk ose kërkonte një kopje të nga adresa e mëposhtme.

Afati i fundit për përgjigjet është **E Enjte 30 Nëntor 2006**. Përgjigjet duhet të dërgohen tek:

Email: community.strategy@camden.gov.uk

Ose tek:

Community Strategy Team
London Borough of Camden
FREEPOST LON 20084
Room 305, Town Hall
Judd Street
London WC1H 9JE

Përgjigjet mund të dorëzohen gjithashtu në sitin camdentogether.org.uk

Për të marrë një kopje të versionit përmbledhës të *Camden Together* në gjuhën tuaj, me shkronja të mëdha, në kasetë dëgjimi ose në versionin e

aftësive të kufizuara në të mësuar, lutemi na kontaktoni në adresën e mësipërme ose në telefononin 020 7974 3257, faksin 020 7974 6057 ose tekstlink (textphone / minicom) 020 7974 6866.

Vizioni ynë për 2012

Camden-i më 2012 :

Krijimi i një bashkie të mundësive

Ne kemi një ekonomi lokale të fortë që përshtatet mirë ndaj ndryshimeve të ardhshme dhe ku më shumë jerez, veçanërisht të rinjtë, mund të aftësohen dhe të kenë akses të arsimit, trajnimit dhe të punëve.

Balancimi i rritjes me ambjentin

Ne punojmë së bashku të akomodojmë një popullsi në rritje ndërkohë që mbrojmë ambjentin dhe cilësinë e jetës. Ne po plotësojmë tani nevojat e njerëzve në Camden dhe po ruajmë dhe trashëgiminë tonë për brezat e ardhshëm.

Ndërtimi i komuniteteve të bashkuara, të forta dhe të shëndetshme

Njerëzit në Camden ndihen si në shtëpinë e tyre, marrin pjesë aktive në demokraci dhe mund të influencojnë vendimet që ndikojnë tek ta. Cilësia e jetës po përmirësohet për të gjithë, veçanërisht për fëmijët, të rinjtë dhe të moshuarit.

Një vend dinamik dhe i sigurt në zemër të një qyteti botëror

Ne ndajmë një pjesë të Londrës që është e sigurt dhe po përparon - dhe që është porta për të hyrë dhe dalë tek pjesa tjetër e Evropës- ku e gjithë popullsia lokale përfiton nga mundësitë kulturore dhe argëtuese të shkëlqyera që janë në pragun e derës tonë, përfshi këtu Lojërat Olimpikë.

Ky vizion është **për këdo** që banon, punon ose studion në Camden, i çfarëdo moshe qoftë. Meqë *Camden Together* është një plan për të ardhmen, ne jemi veçanërisht të interesuar të adresojmë nevojat dhe shqetësimet e fëmijëve dhe të rinjve, prindërve, kujdestarëve, mësuesve të tyre dhe familjet më gjerë.

Pyesni veten.

A kap ky vizion gjërat që kanë rëndësi për njerëzit që banojnë, punojnë dhe rriten në Camden?

Ka diçka që mungon apo gjera që ju i kundërshtoni?

Pikënisja jonë– Camdeni sot

Ne duhet të kuptojmë qartë pikënisjen tonë përpara se të miratojmë drejtimin e së ardhmes. Kjo është një përblehje e shkurtër e fakteve të Camden-it:

- Rezidentët e Camdenit thonë se ka një ndjenjë të fortë dhe që sa vjen e rritet të komunitetit dhe nëntë nga dhjetë njerëz vlerësojnë diversitetin kulturor të bashkisë.
- Popullsia e Camdenit po rritet, relativisht e re dhe diverse, shumë njerëz vijnë dhe shumë të tjerë largohen nga bashkia çdo vit.
- Camden-i ka disa nga lagjet më të pasura në Londër dhe disa nga më të varftrat. Në tërësi, Camden-i është një nga 15 bashkitë më të privuara të Anglisë.
- Kërkesa për strehim me kosto të ulët është 5 herë më e madhe se sa oferta.
- Krimi po po ulet dhe besimi tek policia po rritet këtu dhe në gjithë vendin, por Camden-i po has krimin që prek shumë zona të brendshme të qytetit dhe frika nga krimi është ende problem.
- Biznesi, universitetet dhe spitalet e specializuara po rriten dhe ka problem hapësire për zgjerim.
- Shërbimet lokale siç janë transporti, shkollat, ambjentet për rininë dhe shërbimet shëndetësore janë nën presion nga një popullsi në rritje.
- Camdeni përballlet me sfidat globale të ndryshimeve klimatike dhe kujdesjes për ambjentin. Rezidentët lokalë tashmë riciklojnë më shumë se sa mesatarja kombëtare.
- Pjesëmarrja e Camdenit në zgjedhje në Maj 2006 ishte më e madhja që nga 1994 dhe kjo i rezistoi tendencës kombëtare për një ulje të pjesëmarrjes në zgjedhjet lokale.
- Njerëzit në Camden, si kudo, kanë shpresa në rritje në lidhje me cilësinë e jetës, me shërbimet responsive, zgjedhjes dhe ndikimit në nivelin lokal.
- Camden-i përballlet me rreziqet e sigurisë dhe mundësinë e sulmeve të mëtejshme terroriste.

Krijimi i një bashkie të mundësisë

Ku duam të jemi në 2012

Ne kemi një ekonomi lokale të fortë që përshtatet mirë ndaj ndryshimeve të ardhshme dhe ku më shumë njerëz, veçanërisht të rinjtë, mund të aftësohen dhe të kenë akses të arsimit, trajnimit dhe të punëve.

Sfidat kryesore me të cilat përballemi

Camden-i ka një ekonomi të madhe dhe të sukseshme. Mbi gjysma e bizneseve lokale bëjnë pjesë në industrira profesionale siç janë media, financat dhe sistemi i drejtësisë. Megjithatë, numri i bizneseve lokale është zvogëluar në vitet e fundit dhe shumë njerëz lokalë janë pa punë.

Një nga sidat kyçe është të ndërtojmë duke u mbështetur në suksesin e ekonomisë së Camdenit, me qëllim që ajo të bëhet më e fortë. Kjo do të thotë që të sigurojmë më shumë biznese të zgjedhin të vendosen në Camden. Ne duhet të sigurohemi gjithashtu që më shumë njerëz lokalë të gjejnë punë dhe të qëndrojnë në tregun e punës.

Çfarë mund të bëjmë drejt 2012

- Të ofrojmë fillimin e biznesit dhe këshillë krijuese për të ndërtuar biznese që janë të qëndrueshme dhe të nxisim aktivitet tregtare.
- Të arrijmë që sektori publik, i cili është punëdhënësi i dytë më i madh në Camden, të adoptojë qëndrime krijuese për të rekrutuar një fuqi punëtore më diverse, e dalë më tepër nga komunitet lokale.
- Të ofrojmë më shumë aftësi trajnimi themelore, veçanërisht në gjuhën angleze, por gjithashtu dhe më shumë trajnim të përgjithshme për 'aftësitë për jetën' që i bënë njerëzit më shumë gati për të filluar punë.
- T'i pajisim shkollat tona të mesme me ambiente të shekullit të 21-të duke përfshirë Informatikën (IT) si dhe me ndërtesa nëpërmjet Ndërtimit të Shkollave për programin e së Ardhmes.
- Zhvillimi më tej i aftësive të komunitetit të biznesit lokal për të përkrahur shkollat dhe të rinjtë, veçanërisht atyre që u mungojnë kualifikimet formale.
- Të përqëndrojmë përkrahjen/ndihmën në komplekset tona të strehimit ku është përqëndruar 'mungesa e punës'- duke ofruar kujdesje me çmim të arsyeshëm për fëmijët, aftësi për jetën, trajnime dhe këshillime dhe ofrimin e rrugëve drejt punëve lokale dhe projekteve të trajnimeve dhe drejt arsimit.
- Të rrisim në maksimum mundësitë e trajnimit dhe të punësimit të ofruara nga Lojërat Olimpike të 2012.

Pyesni veten

Dokumenti i plotë i konsultimit ka shumë më shumë fakte, opsione dhe ide. Çfarë mendoni ju për idetë e ngritura më lart rreth krijimit të një bashkie të mundësive?

Këto janë disa pyetje më specifike që ju mund të dëshironit t'ju përgjigjeshit:

- Si do të nxiten personat që kanë dhunti biznesi për të filluar dhe zhvilluar biznese lokale?
- Çfarë duhet të bëhet për të tërhequr më shumë investime në ekonominë lokale?
- Çfarë mund të bëjë ndryshe sektori publik që do të ndihmonte nxitjen e rritjes ekonomike, për shembull, heqjen e metodave burokratike ose të pengesave të tjera për të arritur suksesin e biznesit?
- Në qoftë se ju jeni një punëdhënës në Camden, çfarë përkrahje do t'ju nevojitej për të rekrutuar dhe trajnuar më shumë njerëz lokalë?
- Çfarë mund të bëjë sektori vullnetar dhe ai i komunitetit për të ndihmuar njerëzit të gjejnë punë?
- Si mund të përkrahen njerëzit për t'u trajnuar më tepër në lidhje me aftësitë dhe gjuhën?

Historia e Alisonit

Që të jem e sigurtë, unë nuk mendoj se Camdeni ua bënë njerëzve të lehtë punën për të filluar një biznes të ri. Unë marrë shumë fletëpalosje dhe ka shumë kurse. Ka dhe shumë këshilla. Ka shumë seminare ku mund të shkosh për të filluar dhe menaxhuar një biznes, por ty të nevojitet ndihmë praktike. Një gjë që do të thoja që është e mirë është se kam ritmin e pagesës së biznesit të vogël. Kjo më ka ndihmuar sepse kur ke një biznes të vogël gjëja që ke nevojë është ndihma me paratë për diçka siç është qiraja ose ulje çmimesh, kështu që të jesh në gjendje të fillosh. Unë punësoj njerëz lokale nga Camdeni. E kam më të lehtë të punësojë njerëz lokalë sepse atyre nuk ju duhet të udhëtojnë larg, është më praktikë sepse ne këtu punojmë me orë të zgjatura. Unë mendoj se mund t'i inkurajoni bizneset të punësojnë njerëz lokalë, por ju duhet ta bëni këtë një iniciativë të menduar mirë – ndoshta ta përshkruani biznesin si një ofrues të aftësive. Natyrisht si një biznes i vogël ju po gjeni kohën për t'i dhënë këtij personi aftësi, por në të njëjtën kohë ju po merrni ndihmë falas ”

Balancimi i rritjes me ambjentin

Ku duam të jemi në 2012

Ne punojmë së bashku për të akomoduar një popullsi në rritje ndërkohë që mbrojmë ambjentin dhe cilësinë e jetës. Ne po plotësojmë nevojat e njerëzve në Camden tani dhe ruajmë trashëgiminë tonë për brezat e ardhshëm.

Sfidat kryesore me të cilat përballemi

Popullsia e Camdenit do të rritet gjatë viteve të ardhshme dhe ne shpresojmë që ekonomia do të bëhet dhe më e fortë. Këto ndryshime do të sjellin gjithashtu dhe presione në rritje në ambjentin tonë, në shërbimet publike dhe në mënyrën se si e përdorim hapësirën.

Ne mund të shpresojmë një rritje të trafikut, të përdorimit të energjisë dhe kërkesave për strehim me çmime të arsyeshme. Ne gjithashtu e dimë që njerëzit kanë prioritete të ndryshme – disa njerëzve, për shembull, u pëlqen një jetë natë aktive ndërsa të tjerëve ju pëlqejnë hapësirat e mëdha dhe të qeta.

Sfida jonë është që të ballancojmë këto presione që janë në garë me njëri tjetrin dhe të përmirësojmë cilësinë e jetës tani dhe në të njëjtën kohë të mendojmë dhe për nevojat e brezave të ardhshëm. Ne duhet të gjejmë një mënyrë të përkrahim një popullsi në rritje dhe ekonominë ndërkohë që të ruajmë ambjentin dhe të krijojmë komunitete ku njerëzit mund të jetojnë dhe punojnë tani dhe në të ardhmen.

Çfarë mund të bëjmë drejt 2012

Ta bëjmë Camdenin një 'bashki me karbon të ulët':

- Të sigurojmë që ndërtesat e reja dhe ato që riparohen të jenë mjaft efikente ndaj energjisë.
- T'i inkurajojmë njerëzit të ecin më shumë me këmbë dhe të përdorin transportin publik.
- Të riciklojmë më shumë dhe në rrugë më të mençura për të minimizuar përdorimin e energjisë.
- Të përdorim makina që janë efikente në energji dhe të marrim masa të tilla sic është izolimi i çatisë.

Të përmirësojmë cilësinë e ndërtimit në ambjent:

- Të zbatojmë standarte të rrepta projektimi për të siguruar që dëndësia të shoqërohet me cilësi të lartë në përputhje me ambjentin përreth. .
- Të përdorim kompetencat e planimetrisë së Council-it dhe pozitën si pronar social (social landlord) në përkrahje të standarteve të larta të ambjentit, siç janë përdorimi i paneleve diellore.

- Të sigurojmë që ndërtimet e reja të projektohen në mënyrë të tillë që të shmangin krimin dhe sjelljen anti sociale dhe të kenë infrastrukturë dhe shërbime publike të nivelit të lartë.

Të përdorim më mirë vlerat lokale:

- Të përmirësojmë aksesin ndaj hapësirave të hapura duke përfshirë këtu rrugët lokale për të ecur njerëzit.
- Të gjejmë mënyra që hapësirat dhe ambientet që nuk përdoren mirë për momentin mund të shërbejnë më mirë në të ardhmen.
- Të fusim përsëri në përdorim shtëpi, zyra apo ndërtesa tregtare bosh .

Pyesni veten

Dokumenti i plotë i konsultimit ka më shumë fakte, opsione dhe ide.

Çfarë mendoni për idetë që ngrihen më sipër rreth ambientit dhe ballancimit të rritjes me cilësinë e jetës?

Këtu janë disa pyetje më specifike që ju mund të dëshironit t'u përgjigjeshit:

- Cila mendoni se është rruga më e mire e pajtimit të interesave të ndryshme për të ardhmen e Camdenit?
- Çfarë mund të bëjmë për t'i bërë zonat e parqeve më popullore për rezidentët dhe më efektive?
- A ka mënyra për t'i nxitur njerëzit për shembull për të ricikluar ose për problemin e ndryshimit të klimës? Apo të shqyrtojmë mundësinë e marrjes së masave kundër atyre që, për shembull, hedhin mbeturina apo nuk riciklojnë?

Historia e Sandrës

U rrita në Swiss Cottage dhe kam banuar këtu në 20 vitet e fundit. Nuk mund të banoja diku tjetër. Kjo është aryeja që dua të kujdesem për zonën. Rrugët rezidenciale janë shumë tërheqëse, por mbajtja e tyre në këtë gjendje është e vështirë. Njerëzit nuk kujdesen për pemët dhe shtretërit me bimë të vogla të tyre dhe si rezultat problemet e rrëshqitjes së dheut po bëhen më keq. Të tjerët po i kthejnë kopshtet para shtëpisë në parkingje makinash, duke krijuar probleme të rënda përmbytjesh. Ne u detyruam të dilnim nga apartamenti përdhes për shkak të përmbytjeve dhe për 18 muaj s'mund të ktheheshim aty. Rrëmuja nxit më shumë rrëmujë. Secili duhet të japë kontributin e tij për t'u kujdesur për ambientin. Dy herë në javë na grumbullohen plehrat dhe riciklohen kutitë për gazeta, qelq dhe kanaçe- dhe kjo është e mrekullueshme. Por çfarëdo të bëjë councili, qeveria dhe të tjerët, s'mund t'i detyrosh të tjerët të ndryshojnë. Ata duhet të ndryshojnë vetë, dhe kjo është sfida e vërtetë.

Të ndërtojmë komunitete të bashkuara, të shëndetshme dhe të forta

Ku duam të jemi në 2012

Njerëzit ndihen si në shtëpinë e tyre në Camden, ata marrin pjesë aktive në demokraci dhe mund të ndikojnë në vendimet që ndikojnë tek ta. Cilësia e jetës po përmirësohet për të gjithë, veçanërisht për fëmijët, të rinjtë dhe të moshuarit.

Sfidat kryesore me të cilat përballemi

Njerëzit në Camden ndryshojnë nga njëri tjetri në shumë mënyra – nga raca, origjina etnike, gjuha, besimi, mosha, aftësitë e kufizuara, klasa sociale dhe seksualiteti. Ajo që ne të gjithë ne kemi të përbashkët është dëshira për të jetuar dhe punuar në një vend ku ndihemi si në shtëpinë tonë.

Ne duhet të sigurojmë që njerëzit të kenë mundësitë për të përmirësuar cilësinë e jetës, të ndërveprojnë me njerëz me sfonde të ndryshme dhe të luajnë një rol aktiv në komunitetin tonë dhe në demokraci. Ne duhet të përmirësojmë gjithashtu dhe shëndetin e njerëzve dhe të zvogëlojmë pabarazitë në shëndetin e njerëzve në të gjithë bashkinë.

Camdeni do të vazhdojë të ketë një popullsi relativisht të re. Njerëzit po jetojnë gjithashtu më gjatë dhe popullsia jonë e vjetër shpreson të qëndrojë e pavarur dhe aktive sa më gjatë që të jetë e mundur. Ne kemi një sfidë, atë të plotësimit të nevojave të ndryshueshme të popullsisë sonë duke përfshirë rezidentët tanë të rinj dhe të vjetër.

Çfarë mund të bëjmë drejt 2012

Të ndërtojmë komunitete më të forta dhe më aktive:

- Të sigurojmë që hapësira publike të projektohet mirë dhe t'i bëjë njerëzit të ndihen si në shtëpinë e tyre.
- Të përfshijmë komunitetin në zgjidhjen së bashku të problemeve në lagjet e tyre.
- Të festojmë diversitetin tonë dhe të krijojmë 'sënsin e vendit' nëpërmjet ngjarjeve dhe festivaleve lokale.
- Të zhvillojmë forumet e zonave në gjithë Camdenin, ku rezidentët mund të thonë fjalën e tyre për shërbimet lokale dhe vendimet që ndikojnë tek ta.

Të promovojmë shëndet më të mië për të gjithë:

- Të vëmë një shënjestër ato zona dhe grupe njerëzish që kanë rezultate shëndeti më të dobëta.
- Të përdorim një gamë më të gjerë njerëzish për të dhënë informacion për shëndetin siç është stafi i qëndrave arsimore

Të përmirësojmë jetën e të moshuarëve dhe të rinjve:

- Të zhvillojmë klube mëngjesore pas mësimit në qendrat e fëmijëve.
- Të eksplorojmë të gjitha opsionet për të adresuar mjaftueshmërinë dhe përshtatshmërinë e shkollave të mesme dhe vendeve të këtyre shkollave.
- Të sigurojmë që mendimet e fëmijëve, të rinjve, të kujdestarëve dhe prindërve të tyre të formojnë shërbimet që ata përdorin.
- Të sigurojmë që të moshuarit të jenë në gjendje të banojnë në shtëpi, sa më gjatë që të kenë mundësi dhe të kenë akses të barabartë të aktiviteteve të mundësive në komunitetet e tyre.

Pyesni veten

Dokumenti i konsultimit ka më shumë fakte, opsione dhe ide.

Çfarë mendoni për idetë e ngritura më sipër në lidhje me ndërtimin e komuniteteve të bashkuara, të shëndetëshme dhe të forta?

Këtu janë disa pyje më specifike që ju mund të dëshironit t'u përgjigjeshit:

- Çfarë mund t'ju ndihmonte juve dhe njerëzit që njihni të ndiheni më shumë si në shtëpinë e tyre në Camden?
- Çfarë do t'ju bënte juve dhe njerëzit që ju njihni më të interesuar që të luanit një rol më aktiv në komunitetin tuaj lokal?
- Çfarë do t'ju nxiste juve që të jeni më aktiv, të jetoni në mënyrë më të shëndetshme dhe të kujdeseni më mirë për veten?
- Si mund t'i përkrahim më mirë prindërit, veçanërisht në momentet kyçe dhe në kohë nevojë siç janë krizat familjare dhe gjatë viteve të adoleshencës?
- Si mund të përmirësojmë jetën e të moshuarëve të izoluar që jetojnë në mënyrë të pavarur në komunitetet lokale?

Historia e Maliqit

"Ka shumë gjëra që mund të bënim, në qoftë se do mblidhemi së bashku dhe të shkëmbejmë ide. Ne duhet të kemi më shumë klube për të shkuar, ku mund të takojmë dhe shoqërohemi me njerëz nga sfonte dhe kultura të ndryshme – kjo do të ndihmonte mirëkuptimin dhe zvogëlimin e shumë problemeve. Unë do të dëshiroja të shihja buzëqeshje në fytyrën e secilit. Unë dhe bashkëshortja ime shkonim në Pikën e Takimit për moshat mbi 50 vjeç në zonën ku banonim. Ne zumë shoqëri, bisedonim dhe shkëmbejmë ide. Diçka të tillë duhet të ketë dhe afër nesh. Tani ne shkojmë shumë tek biblioteka lokale. Ne ulemi lexojmë dhe frekuentojmë dhe kafenenë. Unë po shkoj në një kurs informatike (IT) që zhvillohet në bibliotekë. Unë nuk dija asgjë për

kompjuterat përpara se të filloja kursin. Unë kam mësuar se si të dërgojë dhe si të marrë email-a, si të përdorë internetin, si të përdorë messenger-in për të biseduar me të afërmit e mi jashtë shtetit, si të përdor mikrofoning dhe dhe aparatit fotografik. Mbrëmë po bisedoja me nipërit dhe mbesat e mia në Kajro.”

Një vend dinamik dhe i sigurt në zëmër të një qyteti botëror

Ku duam të jemi në 2012

Ne ndajmë një pjesë të sigurt dhe që përparon të Londrës – dhe është portë hyrjeje - daljeje për pjesën tjetër të Evropës- ku të gjithë njerëzit lokalë

përfitojnë nga mundësitë e shkëlqyera kulturore dhe argëtuese në pragun e derës tonë, duke përfshirë Lojërat Olimpike

Sfidat kryesore me të cilat përballemi

Camdeni është një vend i kontrasteve. Është i famshëm për vende të njohura si Hampstead Heath, Biblioteka Britanike dhe pazari i Camdenit, por ka gjithashtu shumë zona banimi dhe rrugë më të vogla. Bashkia ka shumë hapësira të gjelbra të hapura, por gjithashtu dhe një jetë kulturore, jetë nate dhe ambiente arti dinamike.

Në të njëjtën kohë frika e njerëzve nga krimi është e lartë, megjithëse nivelet aktuale të shumicës së krimeve po bien. Shumë njerëz, përfshi të rinjtë, janë të shqetësuar për sjelljen anti-sociale. Një sfidë kryesore është ta bëjmë Camdenin një vend më të sigurt.

Në vitin 2012 Evropa kontinentale do të jetë vetëm 2 orë larg me Eurostar nga St Pancras International. Një sfidë tjetër do të jetë t'i shijojmë në maksimum dhe të përfitojmë pafund nga Lojërat Olimpike dhe Paraolimpike.

Çfarë mund të bëjmë drejt 2012

Nxisni këdo që të luajë një rol që ta bëjë Camdenin më të sigurt:

- Inkurajoni njerëzit të marrin më tepër përgjegjësi për sjelljen e tyre dhe për sjelljen e fëmijve të tyre.
- Të ndikojmë tek vendimet rreth vendosjes së prioriteve të burimeve për të luftuar krimin.

Shfrytëzoni në maksimum hapësirat e hapura dhe parqet e Camdenit:

- Përmirësimet të tilla si të zonave të aktiviteteve të adoleshentëve, kontrollit të qenve, orë të zgjata pune në verë dhe sinjalistikë më të mirë.
- Përmirësimi i ndriçimit, projekteve dhe ambjenteve siç janë kafenetë me qëllim që parqet të përdoren në mënyrë të sigurt në mbrëmje.

Shrytëzoni në maksimum vlerat tona kulturore:

- Sigurohuni që të gjitha komunitetet e Camden-it janë në gjendje dhe janë të inkurajuara të kenë akses më të madh të aktiviteteve dhe ngjarjeve kulturore që zhvillohen

Sigurohuni që ne të kënaqemi në maksimum dhe të përfitojmë pafund nga Lojërat Olimpike të 2012:

- Nxisni përdorimin e qendrave sportive dhe argëtuese ekzistuese, veçanërisht nga personat me aftësi të kufizuara, të moshuarit dhe rezidentët e minoriteteve etnike dhe me ngjyrë. .
- Nxisni dajlen e vullnetarëve si për të përkrahur aktivitetet sportive dhe për të ndihmuar për Lojërat Olimpike.

Pyesni veten

Dokumenti i plotë i konsultimit ka më shumë fakte, opsione dhe ide.

Çfarë mendoni për idetë që ngrihen më lart rreth Camden-it si një vend i sigurt dhe dinamik në zemër të një qyteti botëror?

Këto janë disa pyetje më specifike që ju mund të dëshironit t'u përgjigjeni:

- Si mund shkollat, individët, grupet e komunitetit dhe biznesit të ndihmojnë të inkurajojnë respekt dhe të shkurajojnë krimin dhe sjelljen antisociale?
- Çfarë do të ndihmonte të ulte frikën ndaj krimit dhe të rrisë qetësinë e mendjes tuaj?
- A duhet të inkurajojmë kafenetë dhe aktivitetet në park kundrejt një tarife pagesë, kështu që mund të investojmë në përmirësimin e ambjenteve që ofrojnë?
- Si mund tua bëjmë më të lehtë sa më shumë rezidentëve të Camdenit që të shijojnë aktivitetet kulturore që ofron bashkia?
- Çfarë ju pëlqen në lidhje me Lojërat Olimpikë? Çfarë ju shqetëson?

Historia e Aronit

“Mua më pëlqen të luaj futboll në Ligën e së Dielës së Camdenit. Unë luaja kur isha në shkollë. Shkolla jonë ishte shumë e mirë për sportet. Drejtoresha e shkollës tonë ishte shumë aktive – ajo na aktivizonte të bënim gjera për bamirësi dhe të gjithë fëmijët e pëlqenin një diçka të tillë. Unë mendoj se të rinjtë sot kanë më shumë mundësi të merren me sport, për shkak të zhvillimit të madh të sportit në Camden në vitet e fundit. Dhe me Lojërat Olimpikë ka një mundësi për ta zhvilluar më tepër sportin. Gjëja më e mirë kur banon në Camden është se këtu ke të bësh me të gjitha sferat e jetës. Siç ndodh me pazarin në weekend. Është një atmosferë e tillë – gjen njerëz të çdo lloji dhe nga çdo vend. Dhe ata bëjnë diçka me gjithë paratë që marrin tani. Mendoj që krimi po bëhet më keq, veçanërisht vjedhjet e shtëpive dhe sende të tilla. Kjo ka të bëjë me atë që njerëzve nuk u jepen mundësi të mjaftueshme për t'u merren me diçka tjetër. Në qoftë se do të më jepej mundësia të ndryshoja diçka në Camden, unë do të krijoja më shumë për të rinjtë, si klube të rinjsh që ofrojnë trajnim themelor për të mësuar zanate dhe programin e zdrুক্তtarisë në Kings Cross.”